

Romano Port sh.a
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe aksionerëve të Shoqërisë Romano Port sh.a

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë Romano Port sh.a, (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2015, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.


Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të **Romano Port sh.a** më datën 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.



Teit Gjini
Partner Angazhimi



Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al

28 qershor 2016

Romano Port sh.a
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

AKTIVET	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	7,342,098	4,515,413
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	42,245,882	43,250,733
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	8,861,791	16,120,350
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	5,356,817	3,715,577
Inventari	8	8,682,184	9,668,044
Shpenzime të shtyra	9	2,151,878	930,477
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		58,014	58,884
Total aktive afatshkurtra		74,698,664	78,259,478
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	2,990,480,589	3,081,460,822
Total aktive afatgjata		2,990,480,589	3,081,460,822
Total aktive		3,065,179,253	3,159,720,300
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	145,971,880	149,344,194
Llogari të pagueshme tregtare	12	621,187,843	702,710,277
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	55,026,510	53,867,800
Detyrime tatimore	14	22,403,642	10,090,084
Të tjera detyrime	15	26,575,995	136,629
Total detyrime afatshkurtra		871,165,870	916,148,984
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	11	287,505,518	468,102,472
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	13	581,553,771	507,547,481
Provizione	16	103,000,000	43,000,000
Hua të tjera afatgjata	17	55,081,868	158,837,458
Total detyrime afatgjata		1,027,141,157	1,177,487,411
Totali i detyrimeve		1,898,307,027	2,093,636,395
Kapitali aksionar			
Kapitali i nënshkruar		597,686,000	597,686,000
Rezerva ligjore		12,110,424	8,905,056
Rezerva të tjera		456,287,481	395,385,485
Fitimi i ushtrimit		100,788,321	64,107,364
Total kapitali aksionar	18	1,166,872,226	1,066,083,905
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,065,179,253	3,159,720,300

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Romano Port sh.a
(Vlerat janë në Lek)
Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	513,719,476	390,211,497
Puna e kryer nga njesia ekonomike e kapitalizuar	20	14,438,190	6,856,680
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	(11,816,708)	(23,041,459)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(27,303,986)	(33,554,934)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	22	(16,767,553)	(21,098,791)
2) Të tjera shpenzime	23	(10,536,433)	(12,456,143)
Shpenzime të personelit	24	(91,514,159)	(55,758,448)
1) Paga dhe shpërblime		(83,227,425)	(48,064,572)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(8,286,734)	(7,693,876)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(195,569,640)	(129,318,841)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(64,906,571)	(57,157,996)
Shpenzime financiare	26	(7,018,006)	(12,791,234)
Shpenzime interesi dhe shpenzime			
1) të ngjashme		(16,336,395)	(24,264,626)
2) Shpenzime të tjera financiare		9,318,389	11,473,392
Fitimi/humbja para tatimit		130,028,596	85,445,265
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(29,240,275)	(21,337,901)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi			
1) fitimin	27	(29,240,275)	(21,337,901)
Fitimi/humbja e vitit		100,788,321	64,107,364
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		100,788,321	64,107,364

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Romano Port sh.a

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 Janar 2014	597,686,000	224,933,732	8,905,056		170,451,753	1,001,976,541
Transferim në fitime të mbartura				170,451,753	(170,451,753)	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					64,107,364	64,107,364
Transferim në rezerva të tjera		170,451,753		(170,451,753)		-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	597,686,000	395,385,485	8,905,056	-	64,107,364	1,066,083,905
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					100,788,321	100,788,321
Transferim në rezerva ligjore e të tjera		60,901,996	3,205,368		(64,107,364)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	597,686,000	456,287,481	12,110,424	-	100,788,321	1,166,872,226

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Romano Port sh.a më _____ dhe janë firmosur si më poshtë.

Pino Bare
Pino Bare
Administrator

REPUBLICA E SHQËRISE
ROMANO PORT
SHA
DURRES ALBANIA

Romano Port sh.a
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	100,788,321	64,107,364
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	5,660,449	6,217,211
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	195,569,640	129,318,841
Provizione	60,000,000	43,000,000
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(130,711)	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	5,401,639	(24,098,342)
Rënie/(rritje) në inventarë	985,860	3,050,604
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(47,271,249)	166,797,216
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	321,003,949	388,392,894
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata material	(107,225,096)	(250,130,341)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata material	2,766,400	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(104,458,696)	(250,130,341)
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime/ (pagesa) e huave	(197,382,134)	(109,874,281)
Interes i paguar	(16,336,434)	(24,264,643)
Dividendë të paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(213,718,568)	(134,138,924)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	2,826,685	4,123,629
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	4,515,413	391,784
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	7,342,098	4,515,413

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Romano Port sh.a, është një shoqëri e regjistruar më 19 prill 2005 si shoqëri aksionare. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj si dhe nga ligji 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Shoqëria ka nipt K516255010. Selia e shoqërisë është tek Porto Romano, 500 metra në veri të Hidrovorit, Durrës, Shqipëri.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 597,686 aksione me vlerë nominale 1,000 LEK për një vlerë totale 597,686,000 LEK. Aksionerët e shoqërisë janë:

- 1- Piro Bare me 99.84 % të aksioneve.
- 2- Florenc Gjiguria me 0.06% të aksioneve.
- 3- Xhevat Rira me 0.08% të aksioneve.

Aministrator i shoqërisë është Z. Piro Bare,

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është ndërtimi, shfrytëzimi i portit, shkarkime analiza të lëndëve djegëse, ruajtje objekti, përdorimi i mjeteve detare. Gjatë vitit 2015 shoqëria ka vazhduar operimin e saj duke ofruar shërbimin e shkarkimit të naftës dhe benzines. Ky investim është një koncension për 30 vite, i dhënë nga qeveria shqiptare me të drejtë ripërtëritje.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 79 (2014: 71).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/LEK	137.28	140.14
USD/ LEK	125.79	115.23

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Normat e amortizimit për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e AAM-ve	Norma e Amortizimit ne %
Ndërtesa	5%
Makineri dhe pajisje	5% dhe 20%
Pajisje informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Mjete transporti	10%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e donjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në arkë	281,803	35,749
Mjete monetare në bankë	7,060,295	4,479,664
	<u>7,342,098</u>	<u>4,515,413</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Klientë për fatura të lëshuara	42,245,882	43,250,733
	<u>42,245,882</u>	<u>43,250,733</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Llogari të arkëtueshme tregtare nga palët e lidhura	8,861,791	16,120,350
	<u>8,861,791</u>	<u>16,120,350</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Të tjera kërkesa	5,356,817	3,715,577
	<u>5,356,817</u>	<u>3,715,577</u>

8. Inventari

Inventari paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Lënde të para	8,682,184	9,668,044
	<u>8,682,184</u>	<u>9,668,044</u>

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme	2,151,878	930,477
	<u>2,151,878</u>	<u>930,477</u>

Romano Port sh.a

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

Kosto	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Automjete	Te tjera	Aktive ne proces	Totali
Gjendja më 1 Janar 2014	1,576,711,532	941,388,022	2,745,966	14,603,487	979,453,538	3,514,902,545
Shtesa	85,399,895	92,500,029	17,073,757	3,131,373	52,025,287	250,130,341
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	1,662,111,427	1,033,888,051	19,819,723	17,734,860	1,031,478,825	3,765,032,886
Shtesa	45,087,910	16,348,624	704,167	659,222	44,425,173	107,225,096
Riklasifikime						
Transferime	1,031,478,825	(2,737,273)		(1,031,478,825)		
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,738,678,162	1,047,499,402	20,523,890	18,394,082	44,425,173	3,869,520,709
<i>Amortizimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 1 Janar 2014	276,967,178	269,409,986	1,638,266	6,237,793		554,253,223
Amortizimi i vitit	67,156,335	59,807,734	555,481	1,799,291		129,318,841
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	344,123,513	329,217,720	2,193,747	8,037,084		683,572,064
Riklasifikime						
Amortizimi i vitit	117,186,316	75,856,946	550,270	1,976,108		195,569,640
Nxjerrje jashtë përdorimit		(101,584)				(101,584)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	461,309,829	404,973,082	2,744,017	10,013,192		879,040,120
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	1,317,987,914	704,670,331	17,625,976	9,697,776	1,031,478,825	3,081,460,822
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,277,368,333	642,526,320	17,779,873	8,380,890	44,425,173	2,990,480,589

Romano Port sh.a
 Shënimit e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
 (Vlerat janë në Lek)

11. Huatë

Huadhënësi	Lloji i huasë	Data e		Afati	Monedha	Shuma e principalit	Shuma për t'u shlyer deri		
		marrjes së huasë	Shlyerjes së huasë				Balanca e Mbetur	në 1 vit	mbi 1 vit
Nga Bankat									
Banka Intesa									
San Paolo	Kredi	01.06.2008	31.12.2018	10 Vjet	EUR	5,000,000	205,919,962	71,076,034	134,843,928
Tirana Bank	Kredi	01.06.2008	31.12.2018	10 Vjet	EUR	2,000,000	82,367,995	25,566,341	56,801,654
Abi	Kredi	01.06.2008	31.12.2018	10 Vjet	EUR	3,475,000	144,282,573	48,422,637	95,859,936
							432,570,530	145,065,012	287,505,518

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Furnitorë për fatura të pranuar	620,250,852	702,302,225
Furnitorë për fatura të pambërritura	936,991	408,052
	<u>621,187,843</u>	<u>702,710,277</u>

13. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Llogari të pagueshme tregtare ndaj palëve të lidhura	55,026,510	53,867,800
Llogari të pagueshme të tjera ndaj palëve të lidhura	581,553,771	507,547,481
	<u>636,580,281</u>	<u>561,415,281</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	9,109,062	1,035,016
Detyrime për TAP	1,444,003	220,954
TVSH për t'u paguar	6,190,128	2,616,903
Detyrimi për tatimin mbi fitimin	5,660,449	6,217,211
	<u>22,403,642</u>	<u>10,090,084</u>

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Paga për t'u paguar	26,575,995	136,629
	<u>26,575,995</u>	<u>136,629</u>

Romano Port sh.a
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
 (Vlerat janë në Lek)

16. Provizione afatgjata

Provizione afatgjata më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Provizione në fillim të vitit	43,000,000	43,000,000
Shtesa	60,000,000	-
Rimarrje	-	-
	<u>103,000,000</u>	<u>43,000,000</u>

17. Hua të tjera afatgjata

Huamarrje të tjera afatgjata më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Huamarrje të tjera afatgjata	55,081,868	158,837,458
	<u>55,081,868</u>	<u>158,837,458</u>

18. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqërisë është 597,686,000 LEK i zotëruar nga aksionerët si vijon:

	31 dhjetor 2015			31 dhjetor 2014		
	Aksionet	Vlera nominale	%	Aksionet	Vlera nominale	%
Piro Bare	596,786	1,000	99.84%	596,786	1,000	99.84%
Xhevat Rira	500	1,000	0.08%	500	1,000	0.08%
Florenc Gjiguria	400	1,000	0.06%	400	1,000	0.06%
	<u>597,686</u>		100%	<u>597,686</u>		100%

Shoqëria ka fitim më 31 dhjetor 2015 në vlerën 100,788,321 LEK (2014: 64,107,364 LEK).

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shitje neto	513,719,476	390,211,497
	<u>513,719,476</u>	<u>390,211,497</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2015</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	543,458,609
Qarkullim i tatueshem	
Zbriten autofaturimet sipas librit të shitjes 2015	(9,123,950)
Shtohet puna e kryer për vetë njësinë paraqitur në librin e shitjes si autofaturim	1,587,965
Zbritet vlera kontabël neto e aktiveve të shitura përfshirë në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	(2,635,689)
Diferenca në të ardhurat e shtyra	(870)
Zbriten diferencat e kursit përfshirë në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	(16,945,107)
Shuma e qarkullimit e korrigjuar	<u>516,340,958</u>
Sipas Kontabilitetit	<u>516,340,958</u>
Diferenca	<u>-</u>

Romano Port sh.a
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
 (Vlerat janë në Lek)

20. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Nga shitja e materialeve dhe mallrave	3,668,575	7,314,916
Të tjera të ardhura nga shitja e shërbimeve- qira	1,145,326	1,862,502
Penalitet dhe gjoba të arkëtuara	-	350,586
Të ardhura të tjera	183,954	251,438
Rezultati nga shitja e AAM-ve	130,711	-
Rezultati nga kursi i këmbimit	(16,945,274)	(32,820,901)
	(11,816,708)	(23,041,459)
Rezultati nga shitja e AAM-ve		
	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	2,766,400	-
Vlera kontabël neto e AAM-ve të shitura	(2,635,689)	-
	130,711	-
Rezultati nga kursi i këmbimit		
	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të ardhura nga kursi i këmbimit	569,343	3,177,089
Humbje nga kursi i këmbimit	(17,514,617)	(24,524,598)
	(16,945,274)	(21,347,509)

21. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Materiale të para	16,767,553	21,098,791
	16,767,553	21,098,791

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Blerje energji, avull, ujë karburant	4,801,631	3,159,324
Shpenzime qiraje	-	1,500,000
Mirëmbajtje dhe riparime	539,885	101,380
Prime sigurimi	288,209	429,360
Shpenzime të ndryshme	3,454,783	1,777,343
Publicitet, reklama	-	2,806,800
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	819,457	901,298
Komisione bankare	227,309	781,519
Taksa të ndryshme	398,159	999,119
Shpenzime pritje dhe përfaqësimi	7,000	-
	10,536,433	12,456,143

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime page	83,227,425	48,064,572
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	8,286,734	7,693,876
	91,514,159	55,758,448

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 79 (2014: 71).

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Gjoka dhe penalitete	4,906,571	14,157,996
Provizione	60,000,000	43,000,000
	64,906,571	57,157,996

25. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime për interesa	(16,336,434)	(24,264,643)
Të ardhura nga interesat	39	17
Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit për aktivitetin financues	9,318,389	11,473,392
	<u>(7,018,006)</u>	<u>(12,791,234)</u>

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	130,028,596	85,445,265
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	64,906,571	56,807,410
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	4,906,571	14,157,996
Të ardhura të patatueshme		(350,586)
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)	60,000,000	43,000,000
Shpenzime të tjera	-	-
<i>Fitimi para tatimit (përfshire shpenzimet e panjohura)</i>	194,935,167	142,252,675
<i>Tatim fitimi @15%</i>	29,240,275	21,337,901
Fitimi i periudhës	<u>100,788,321</u>	<u>64,107,364</u>

28. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Të arkëtueshme	Të Pagueshme	Të arkëtueshme	Të Pagueshme
INTER-GAZ SHA		55,040,312	14,216,313	91,364,700
A&V GAS SHA	2,077,204	32,540,402	763,077	(252,852,737)
ALBA OIL SHA	1,140,960	86,201,723	1,140,960	83,900,180
A&V Gas Distribution sha	5,643,627	812,488		825,644
A&V Gas Distribution sha		1,292,750		
PORT-CONSTRUCTION SHPK		53,878,384		53,867,800
Detyrime ndaj Ortakut		406,814,222		584,309,694
	8,861,791	636,580,281	16,120,350	561,415,281
	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
A&V GAS SHA	83,589,665	16,778,376	62,658,657	
A&V Gas Distribution sha	5,643,627	1,292,750		
INTER-GAZ SHA			14,216,313	
PORT-CONSTRUCTION SHPK			384,000	
	89,233,292	18,071,126	77,258,970	-

Shpërblimi total i dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 është 22,042,746 LEK.
 Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

29. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

MAZARS SHPK

Address: Rruga Emin Duraku,
Pall. Binjaket, No.5
Tirana, 1000
Tel. +355 4 222 2889
Fax. +355 4 222 2889

www.mazars.al